

Biografi – Ejona Icka

Ejona Icka është pedagoge në Fakultetin e Psikologjisë në UBT, ku ligjeron *Psikologjinë e Sjelljes Seksuale* dhe *Seksualitetin Human*. Ajo ka përfunduar studimet Master në Psikologji Klinike dhe është studente e doktoraturës në Universitetin “Shën Klimenti i Ohrit” në Maqedoninë e Veriut. Ejona Icka është e licencuar si psikologe klinike nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës.

Me përvojë mbi dhjetëvjeçare në fushën klinike dhe psikosociale, znj. Icka ka punuar si psikologe klinike në KRCT, duke ofruar mbështetje për viktimat e dhunës me bazë gjinore, grupet vulnerabël dhe personat nën mbrojtjen e UNHCR. Ekspertiza e saj përfshin terapinë individuale, ndërhyrjet sistemike familjare, menaxhimin e rasteve dhe punën me grupe mbështetëse.

Ajo ka specializuar në Terapinë Seksuale, me certifikim nga **ESSM School of Sexual Medicine** në Budapest (Hungari), si dhe në Terapinë Sistemike Familjare, të përfunduar pranë **Nederlandse Vereniging voor Relatie- en Gezinstherapie (NVRG)** në Amsterdam (Holandë). Në vijim të zhvillimit profesional, ajo ka ndjekur gjithashtu trajnime të avancuara në psikiatri forenzike, traumë dhe metodologjitë bashkëkohore të ndërhyrjes psikoterapeutike.

Znj. Icka është autore dhe bashkëautore e disa publikimeve ndërkombëtare në psikologjinë klinike, seksualitet dhe shëndet mendor, dhe njihet për qasjen e saj profesionale, bashkëpunuese dhe të orientuar drejt zhvillimit akademik dhe personal të studentëve.